



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



DKAKRS

05. Nr. ____-23

Me datë: 13.07.2023

Komuna e Mamushës

Në bazë të nenit 4 nenit 10, 11 dhe 13 të Rregullores MF- nr 04/2017 mbi Kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, nenit 4 dhe 5 të Rregullores 01-007-19 së brendshme Kushtet Kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve. Statutit të Komunës së Mamushës. DAKRS shpall këtë

Thirrje Publike për OJQ-të

Komuna e Mamushës, përkatësisht Drejtora për Arsim, Kulturë Rini dhe Sport, përmes kësaj shkrese bën thirrjen publike për aplikimin e të gjithë OJQ-ve, të regjistruar në Republikën e Kosovës që selinë dhe adresën e shoqatës e kanë në territorin e Komunës së Mamushës që programi i punës i të cilëve është i funksionuar në fushën e *Kulturës* në Komunën e Mamushës.

Qëllimi

Qëllimi i kësaj thirrje është subvencionimi i OJQ-ve të cilët kanë për qëllim nxitjen e aktiviteteve kulturore në Komunën e Mamushës.

Aktivitete që synojnë avancimin e politikave lokale dhe qeveritare në fushën e avancimit dhe promovimit të aktiviteteve kulturore.

- **Projektet nga fusha e kulturës** Promovimin e vlerave dhe aktivitete të cilat kanë të bëjnë me festivale, koncerte, shënimin e datave historike dhe kulturore, simpoziumet, ekspozita dhe promovimin e librave për botim.

Specifikat Tjera të Thirrjes Publike

- Thirrja publike për aplikim hapet me **12.07.2023** dhe mbyllet me **01.08.2023** (**APLIKACIONET E DËRGUARA PAS AFATIT NUK DO TË MEREN PARASYSH**)
- Aplikacionet e pa kompletuara sipas kriterëve të përcaktuara në këtë thirrje do të refuzohen.
- Zbatimi i projekteve do të monitorohen nga personi përgjegjës i përcaktuar nga DAKRS.
- Mbështetësi financiar, përkatësisht Komuna e Mamushës dhe përfituesi i donacionit do të lidhin kontratë me të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve
- Me secilën OJQ që do të jetë përfituese e subvencionit do të nënshkruhet një kontratë përfituese të mjeteve financiare dhe mbështetësit financiar.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim.

1. Projekt propozimi përfshirë agjendën, aktivitetet, planifikimi dhe lindje buxhetore në harmoni me qëllimin e projektit
2. Aplikacioni sipas modelit të DAKRS
3. Dokumenti Identifikues (letërnjoftimi i personit të autorizuar nga OJQ)
4. Certifikata e vendbanimit për (persona fizik)
5. Certifikata e regjistrimit në MAP (për persona juridik)

6. Dëshmi për pagesën e taksave komunanle
7. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (për persoant fizik)
8. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-ës (për persona Jurdik)
9. Konfirmimi bankar për gjirollgarinë e aplikuesit dorëzohet pas shpalljes së fituesit.
10. Raporti financiar per vitin paraprak 2022(kjo vlen vetëm për OJQ që kanë pranuar subvencione ne vitin e kaluar.)
11. Deklarata për mos financim të dy fisht.

